



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA MALISHEVË
ZYRTARJA PËR BARAZI GJINORE



Datë:29.01.2025

Nr:01/298

***Raporti i punës - ZBGJ
Janar-Dhjetor 2025***

Barazia gjinore përbën një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike dhe gjithëpërfshirëse, duke garantuar mundësi të barabarta, trajtim të drejtë dhe pjesëmarrje të plotë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës shoqërore, ekonomike, sociale e politike.

Në kuadër të saj, gjatë vitit 2025, kemi realizuar aktivitete dhe iniciativa me qëllim të promovimit të barazisë gjinore duke përfshirë institucionet shkollore, grupe të grave dhe komunitetin në përgjithësi.

Andaj, raporti i punës paraqet një pasqyrë të angazhimeve, rezultateve dhe sfidave të hasura gjatë vitit, si dhe bashkëpunimin e zhvilluar, me synimin që sukseset e arritura të përcillen dhe të shërbejnë më tej në raport me qytetarët.

Do të jemi të përkushtuar që edhe në të ardhmen të vazhdojmë punën për avancimin e barazisë gjinore, duke ndërtuar politika dhe veprime gjithëpërfshirëse që garantojnë trajtim të barabartë dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët.

Angazhimi i vazhdueshëm dhe bashkëpunimi me komunitetin do të jenë prioritet i yni për arritjen e rezultateve të qëndrueshme.

Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025



Barazia gjinore proces i vazhdueshëm institucional dhe shoqëror.

Takim pune, me pjesëmarrje të përfaqësuesve të grupit të grave, organizata Handikos, OJQ 'Fatjona', Unioni i të Verbërve, përfaqësues nga komiteti për komunitete, QPS, Zyra Juridike Falas dhe pjesëmarrës tjerë, në të cilin u diskutua për raportin vjetor, aktivitetet e realizuara dhe promovimin e barazisë gjinore si një prioritet thelbësor, në mjedise pune gjithëpërfshirëse si dhe sfidat që duhet adresuar përgjatë veprimtarive me komunitete të niveleve të ndryshme shoqërore, arsimore, fokus grupe të të dy gjinive me qëllimin e vetëm për të siguruar që i gjithë komuniteti, pavarësisht nga gjinia, të kenë mundësi të barabarta për zhvillim profesional dhe personal.

Takim jo formal për planifikimin dhe koordinimin për realizimin e takimit me aktorët e mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje, me qëllim, planifikimin dhe koordinimin e veprimeve për takimin e ardhshëm, e pranishme edhe drejtoresha e strehimores në nivel regjional .





Takim me akterët e mekanizmit koordinues i cili përbënte vazhdimësi të takimeve të mëparshme, ku ndër të tjera u fokusua në adresimin e dhunës në familje, në zbatimin e Strategjisë Komunale kundër dhunës në familje, me qëllim për të vazhduar dhe forcuar më tutje bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitutional duke rekomanduar:

Që të organizohen takime të rregullta koordinuese për shkëmbimin e informacionit dhe praktikave më të mira përmes akterëve të mekanizmit, Të zhvillohen veprime konkrete për mbrojtjen e viktimave, përfshirë referimin e menjëhershëm të rasteve dhe poashtu duke mundësuar kushte dhe hapësirë për zyrtaret për të cilat merren me rastet tilla



Takimi i radhës u realizua me grupin e grave, ku secila prej tyre përfaqësonte rrethin ku jetonte dhe kishte detyrë të përcillte informacionin tek gratë e tjera në komunitet.

I ftuar ishte **Zyrtari për Ndihmë Juridike Falas** nga i cili u njohëm me punën dhe mundësinë mbi mënyrën si mund të përfitojnë nga ky shërbim. Diskutimi ndër të tjera u ndërlidh për alimentacionin në raste të shkurorëzimit, mundësinë e ndryshimit të ligjit për pensione (15 vite përvojë) e shumë tema tjera për të cilat kishte interesim.

Java e Edukimit për Barazi Gjinore

Orë mësimore për barazi gjinore në shkolla

Gjatë Javës së Edukimit për Barazi Gjinore, u organizuan orë mësimore në të gjitha shkollat e komunës, në bashkëpunim me mësimdhënësit e edukatës qytetare dhe të artit pamor

Nxënësit u njohën me konceptin e barazisë gjinore, rëndësinë e saj në jetën shoqërore dhe rolin që secili mund të ketë në promovimin e saj.

Punime dhe ese nga nxënësit

Nxënësit përgatitën punime dhe ese mbi barazinë gjinore, të cilat u vendosën në këndet shkollore për t'u prezantuar dhe diskutuar me të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit

Këto aktivitete ndihmuan në rritjen e ndërgjegjësimit dhe mundësuan një diskutim të hapur mbi idetë dhe përvojat e tyre lidhur me barazinë gjinore.

Ndarja e mirënjohjes për mësuesen e parë në fshatin Ngucat


Në bashkëpunim me shkollën, bashkëpunëtorin e Zyrës për Barazi Gjinore njëherit asambleist në Asamblesë Komunale, ndamë mirënjohje për mësuesen e parë të fshatit, për kontributin dhe angazhimin e saj në edukimin dhe promovimin e barazisë gjinore.

Ky aktivitet kishte për qëllim të vlerësojë punën e mësimdhënësve dhe të motivojë vazhdimisht për të kontribuar në edukimin gjithëpërfshirës dhe barazinë gjinore.

Drekë pune me grupin e grave

Me grupin e grave u organizua një drekë pune, ku u diskutua për punën, sfidat dhe sukseset e tyre. Gjatë këtij takimi, pjesëmarrëset ndanë përvojat dhe kërkesat e tyre, duke identifikuar nevojat konkrete për përkrahje dhe zhvillim të aktiviteteve të ardhshme. Ky takim forcoi bashkëpunimin ndërmjet grave dhe institucioneve komunale, duke krijuar mundësi për planifikime të përbashkëta dhe përmirësim të jetës dhe mundësive të barabarta në përgjithësi.

Foto nga aktivitetet e Javës së Edukimit për Barazi Gjinore











Takim pune për të vlerësuar dhe forcuar bashkëpunimin e gjatë dhe të vazhdueshëm me Rrjetin “Qeliza”.

Gjatë takimit u koordinuam për aktivitetet dhe planifikuam takimet e radhës, me qëllim të bashkëpunimit, ndarjes së përvojave mes grupeve të grave për temat të cilat ndërlidhen me të drejtat e grave dhe fuqizimin e tyre në sfera të ndryshme të jetës shoqërore, si në arsim, shëndetësi, vendimmarrje, biznes e fusha tjera.



Tryeza: **Histori suksesi**

Debati i zhvilluar mes grave të suksesshme shpërfaqti përvojat dhe historitë e tyre të suksesshme, duke përfshirë gra nga fusha të ndryshme si: arsimi, shëndetësia, politika, sektori i OJQ-ve dhe biznesi, me qëllim ndarjen e përvojave frymëzuese dhe nxitjen e fuqizimit individual dhe kolektiv në Komunën e Malishevës.



Takim me gratë fermere, dhe diskutim mbi rolin e tyre në zhvillimin ekonomik dhe social. Përmes bashkëbisedimit dhe njohjes nga afër me punën e tyre të përditshme, u identifikuan sfidat, përkushtimi dhe potenciali i grave fermere, duke forcuar bindjen për rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme dhe të qëndrueshme si shembull për të inkurajuar gratë tjera për të punuar në fusha të ndryshme dhe për të promovuar produktet e tyre me pjesëmarrjen nëpër panairë.



Aktivitet me nxënëse, me rastin e Një Qershorit - bashkarisht vizituam dhe nderuam me përlulësi skulpturën e Leotrim Ahmetajt, 7-vjeçarit të pafajshëm, i cili u vra mizorisht nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë.

Në nderim të jetës dhe sakrificës së tij, nxënëset krijuan poezi prekëse që pasqyrojnë dhimbjen, mallin dhe krenarinë për këtë engjell të lirisë.



Me rastin e pensionimit të drejtoreshës së Hansikosit, e cila për më shumë se 25 vite ka dhënë një kontribut të vyer profesional dhe njerëzor.

Ajo ishte gjithashtu një bashkëpunëtore e ZBGJ dhe vazhdon të jetë, duke u angazhuar me përkushtim në promovimin e barazisë gjinore.



Roli i grave në ruajtjen e trashëgimisë kulturore

Në kuadër të aktiviteteve me grupin e grave, u zhvillua një diskutim tematik me pjesëmarrjen e zyrtarit të muzeut, ku u trajtua rëndësia e rolit të grave në ruajtjen e trashëgimisë kulturore. U theksua kontributi i tyre ndër vite për ruajtjen e objekteve tradicionale, ruajtjen e zakoneve dhe festave lokale, si dhe për përcjelljen e njohurive kulturore tek brezat e rinj.”



Aktiviteti i radhës u realizua në bashkëpunim me QKMF–Malishevë dhe Poliklinikën TritiFarm, ku u kryen vizita mjekësore për 17 gra. QKMF–Malishevë luajti rol kyç në koordinimin dhe mbështetjen profesionale të aktivitetit, ndërsa Poliklinika Tritifarm ofroi shërbimet mjekësore. Me këtë rast, iu nda mirënjohje udhëheqësit të Poliklinikës Tritifarm, në shenjë falënderimi për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë.



Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Komitetin për Komunitete duke përfshirë aktivitete të përbashkëta dhe iniciativa për fuqizimin e komuniteteve, duke i përfshirë në aktivitetet tona edhe gratë nga komuniteti RAE



Degjimi Buxhetor – Perfshirja e prioriteteve gjinore

Nga gratë pjesëmarrëse të takimit u paraqitën kërkesa nga fusha të ndryshme, duke përfshirë buxhetimin gjinor, investime në cerdhet e fëmijëve, subvencione, shëndetësi, fushata, siguri publike, pjesëmarrje e grave në vendimmarrje, organizime të panairëve e kështu me radhë. Poashtu të gjitha kërkesat e parashtruara gjatë diskutimit u dorzuan edhe me shkrim në drejtorin për buxhet e financa.



Në bashkpunim me Integra realizuam aktivitetin: Le të flasim:

“Rri n’Kosovë, se ma mirë s’ka”

"Le të flasim" është një seri takimesh të fokusuara te të rinjtë, që zhvillohen nëpër komuna të ndryshme të Kosovës. Këto ngjarje sjellin së bashku të rinj, anëtarë të komunitetit dhe udhëheqës lokalë për të diskutuar sfida reale, për të ndarë ide dhe për të bashkë krijuar zgjidhje lokale. Përmes dialogut të hapur, kjo iniciativë synon t’i frymëzojë të rinjtë të shohin të ardhmen e tyre pikërisht këtu – sepse vërtet nuk ka vend më të mirë se Kosova



Një shoqëri për të gjithë

Me pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, pjese e takimit ishte edhe zyrtarja nga Drejtoria e Urbanizmit, e cila prezantoi situatën aktuale të qasjes në hapësirat publike dhe diskutoi sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e infrastrukturës. Pjesëmarrësit ndanë përvojat e tyre personale, duke identifikuar pengesat që hasin për lëvizjen dhe përdorimin e hapësirave publike, dhe u propozuan disa masa konkrete për t'i bërë ato më të qasshme për të gjithë.”



Në bashkëpunim me QKRMT zhvilluam një takim me qëllim: Adresimin e stigmës ndaj viktimave, identifikimin dhe referimin e rasteve të reja që kërkojnë mbështetje

Ky bashkëpunim është hap i rëndësishëm drejt rritjes së ndërgjegjësimit, përmirësimit të qasjes në shërbime dhe ndërtimit të një rrjeti më të fortë të mbështetjes për të gjithë ata që kanë nevojë.



Fushata ndërgjegjëse për promovimin e Barazisë Gjimore në proceset zgjedhore

Takimi i radhës u realizua me pjesëmarrjen e zyrtarëve nga KKZ me qëllim promovimin e barazisë gjimore në proceset zgjedhore. Takimi përfshiu informim dhe sensibilizim të pjesëmarrësve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në vendimmarrje, duke diskutuar për një angazhim aktiv dhe respekt për të drejta.



Rëndësia e pjesëmarrjes së grave në politikë

E pranishme në panel ishte ish asambleistja dhe aktivistja në politike njëherit edhe bashkëpunëtore e jona, e cila dha kontributin dhe përvojën e saj në politikë para të pranishmeve. Pjesëmarrëset shprehën interesim për politikatat në nivel lokal dhe më tutje dhe ndër të tjera ato paraqitën një vetëdijësim dhe sensibilizim për mënyrën e votimit në të kaluarën dhe ndryshimet personale të secila prej tyre ndër vite.



Shkaqet e emigrimit të të rinjëve dhe familjeve nga vendi –përkrahur nga Rrjeti “Qeliza”

Përgjate takimit në përgjithësi u diskutua për emigrimin dhe rënjen e numrit të banorëve në teritorin e komunës së Malishevës, rënjen e numrit të nxënësve nëpër shkolla dhe lëvizjen e tyre brenda Kosovës.

Pjesëmarrëset shprehën përvojat e familjarëve të tyre rreth emigrimit dhe ndikimit të emigrimit të familjeve përgjatë periudhës jetësore. Pjesëmarrëse Rrjeti “Qeliza”



Kujdesi ndaj shëndetit mendor dhe fizik tek të rinjtë –përkrahur nga Rrjeti “Qeliza”

Bashkëbisedim –me të rinjë u ngritën shumë tema të cilat ndërlidhen me shëndetin mendor dhe fizik tek të rinjtë, rëndësia e pjesëmarrjes së tyre në aktivite sportive dhe rekreative, të cilat ndikojnë në shëndetin e tyre në përgjithësi. Sipas tyre ata ndjekin edhe ligjërata e aktivitete të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me shëndetin mendor dhe fizik përgjatë vikendeve, duke ju bashkangjitur edhe ecjeve për raste të caktuara në vise të ndryshme të vendit tonë.



Vajzat në TIK-Njohuri dhe Guxim - Aktiviti i radhës u realizua me vajzat në SHFMU “Ibrahim Mazreku” Aktiviteti synoi fuqizimin e vajzave në përdorimin e teknologjisë informative dhe komunikimit, duke i inkurajuar të zhvillojnë aftësi digjitale dhe të sfidojnë stereotipet gjinore që shpesh kufizojnë mundësitë e tyre në këtë fushë, e pranishme edhe mësimdhënësja e TIK. Poashtu realizuam edhe një pyetësor me mësimdhënësit e TIK me qëllim që të kuptojmë nivelin e interesimit të vajzave për TIK, ku sipas përgjigjeve shumica e vajzave kanë interesim dhe motivim për të mësuar në këtë fushë, duke reflektuar gatishmërinë dhe kuriozitetin e tyre për zhvillimin e aftësive digjitale.

Aktivite të realizuara gjatë muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit

Takime për koordinimin e aktiviteteve me bashkëpunëtorë

U organizuan takime dhe biseda me bashkëpunëtorë për planifikimin dhe koordinimin e aktiviteteve për muajin e ndërgjegjësimit, duke siguruar pjesëmarrje aktive dhe mbështetje për të gjitha aktivitetet.

Ecje simbolike

U organizua një ecje simbolike për të treguar solidaritet me gratë e prekuara nga kanceri i gjirit dhe për të rritur ndërgjegjësimin e komunitetit mbi rëndësinë e diagnostikimit të hershëm, Poashtu u mbollën lule në mënyrë simbolike për të përkujtuar humbjen e kolegeve (QKMF) nga kjo sëmundje, duke shprehur respekt dhe solidaritet me të gjithë të prekurat.

Aktiviteti sportiv – lojë miqësore me klubin e vajzave në volejboll:

U zhvillua një lojë miqësore volejboli, ku bashkarisht u angazhuam për të promovuar shëndetin dhe solidaritetin, duke përcjellur mesazhin e fuqizimit dhe kujdesit për gratë e prekuara.

Bashkëpunimi me biznese

Organizuan shitje me moton “Ju nuk jeni vetëm”, ku të ardhurat u dedikuan për mbështetje të grave që përballen me kancerin e gjirit.

Takimi me nxënës dhe prezentimi i punimeve


Nxënësit prezantuan përmes artit dhe performancave kreative luftën kundër kancerit të gjirit, duke rritur ndërgjegjësimin dhe duke përcjellur mesazhe pozitive për mbështetje dhe solidaritet.

Foto nga aktivitetet gjatë muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit











Mos hesht-Fushata kundër trafikimit me qenie njerëzore

Kjo fushatë ka për qëllim ngritjen e vetëdijes tek qytetarët, veçanërisht tek të rinjtë, për rreziqet dhe mënyrat e mbrojtjes nga trafikimi me qenie njerëzore.

Në kuadër të aktiviteteve janë realizuar orë mësimore nëpër shkollat e komunës me temën: “Mbrojtja dhe Parandalimi nga Trafikimi me Qenie Njerëzore”, ku nxënësit janë informuar mbi format e trafikimit dhe institucionet ku mund të kërkojnë ndihmë.

Në kuadër të fushatës kundër trafikimit me qenie njerëzore, u përfshinë të gjitha shkollat e komunës përmes aktiviteteve të ndryshme ndërgjegjësuese. Në bashkëpunim me arsimtarët e edukatës qytetare, gjatë një ore mësimore u realizuan ligjërata dhe diskutime tematike mbi trafikimin me qenie njerëzore, duke trajtuar format, rreziqet dhe mënyrat e parandalimit.

Nxënësit u angazhuan gjithashtu në hartimin e punimeve kreative, përmes të cilave shprehën njohuritë dhe qëndrimet e tyre lidhur me këtë dukuri. Për të vlerësuar nivelin e njohurive dhe ndërgjegjësisimit, u realizua edhe një pyetësor me gjithsej 143 nxënës.





Përmbledhje e pyetësorit

Mbrojtja nga Trafikimi me Qenie Njerëzore

Pyetësi, është plotësuar nga nxënësit e shkollave ku ne ishim të pranishëm në aktivitete, u realizua me 143 nxënës, kishte si qëllim të rrisë vetëdijen mbi trafikimin e qenieve njerëzore dhe mënyrat për mbrojtje dhe parandalimin e tij.

Pyetësi është përpiluar me gjithsej 10 pyetje me nga tri alternativa.

Vlenë të përmendet se të gjitha shkollat kanë qenë të përfshira në aktivitete, me ligjërata, punëtori, prezantime, duke dhënë mesazhe të rëndësishme


Nga përgjigjet e nxënësve rezulton se ata kanë **njohuri të mira mbi konceptin e trafikimit**, duke e kuptuar atë si **shfrytëzim të njerëzve për përfitime materiale ose të tjera**. Ata njohin **format më të zakonshme të trafikimit**, si shfrytëzimi seksual, puna e detyruar dhe lypja e detyruar, dhe e kuptojnë që **çdokush mund të bëhet viktimë**, pavarësisht moshës, gjinisë apo gjendjes sociale.

Nxënësit treguan gjithashtu **njohuri mbi mënyrat që trafikantët përdorin për të mashtruar viktimat**, si premtime për punë jashtë vendit, dhurata, para dhe mashtrime online. Ata identifikuan **shenjat e viktimizimit**, si kontrolli nga të tjerët, mungesa e dokumenteve personale dhe punë e detyruar pa pagesë.

Është evidentuar se ndërgjegjësimi i nxënësve mbi **masat për mbrojtje**, duke përfshirë kujdesin ndaj dokumenteve personale, mosbesimin ndaj ofertave të dyshimta dhe raportimin te prindërit, mësuesit apo policia. Ata njohnin edhe **institucionet dhe linjat e ndihmës**, duke treguar njohuri mbi mbrojtjen dhe asistencën që ofrohet për viktimat e trafikimit.

Në përgjithësi, pyetësi tregon se nxënësit janë të vetëdijshëm për rreziqet e trafikimit dhe për mënyrat për t'u mbrojtur, dhe se edukimi i vazhdueshëm në shkollë është një mjet i rëndësishëm për **forcimin e vetëdijes dhe mbrojtjes personale**.





Takim me kryetarët e fshatrave dhe zyrtarët komunal, me fokus informimin, identifikimin dhe referimin e të mbijetuarëve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë në bashkëpunim me QKMRT.

Gjatë takimit u diskutua rëndësia e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve lokale dhe komunitetit, në mënyrë që të mbështeten më mirë personat që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës.



Aktiviteti mbi **Promovimin e Barazisë Gjinore përmes të Rinjëve** u zhvillua me pjesëmarrjen e të rinjëve, me qëllim të edukimit dhe arsimimit mbi perceptimin e barazisë gjinore nga këndvështrimi i tyre si bartës të proceseve dhe ndryshimeve për të drejta dhe barazi duke u përcjellur edhe me një aktivitet praktik punuar nga ana e nxënësve.

Pas realizimit të punës praktike dhe prezantimit të punimeve nga nxënësit, në përfundim secili nxënës paraqiti nga një thënie lidhur me barazinë gjinore dhe secili nga këndvështrimi i tyre.

Të gjithë jemi të barabartë, pavarësisht nëse jemi vajza apo djem, barazia gjinore do të thotë të kemi të njëjtat të drejta dhe mundësi, respekti dhe barazia janë baza e një shoqërie të drejtë, forca e një shoqërie qëndron në barazinë mes vajzave dhe djemve, të gjithë mund të ëndërrojmë dhe të arrijmë njësoj, barazia gjinore fillon me respektin ndaj njëri-tjetrit, nuk ka punë për vajza apo për djem, ka vetëm aftësi, kur jemi të barabartë, jemi më të fortë së bashku.



Dhuna në Familje-Shkaqet dhe Pasojat – përkrahur nga Rrjeti “Qeliza”

Në aktivitetin e radhës u diskutua lidhur me dhunën në familje, shkaqet dhe pasojat, bashkëbiseduam me zyrtares hetuese për rastet e dhunës nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor-Malishevë. Ku ndër të tjera u diskutua për bashkëpunimin ndër-institucional si dhe fushatat vetëdijësuese dhe sensibilizuese për parandalimin e dhunës në familje.

Poashtu u theksua se dhuna shfaqet në forma të ndryshme dhe ndikon negativisht te individi, fëmijët dhe shoqëria.

Rritja e ndërgjegjësimit, forcimi i komunikimit në familje, respektimi i barazisë gjinore, raportimi i rasteve të dhunës dhe bashkëpunimi me institucionet përkatëse për parandalimin dhe trajtimin e këtij fenomeni u pa si domosdoshëm për parandalimin e dhunës në familje.



Prezantimi mbi ***diversitetin dhe barazinë gjinore*** para dy grupeve të nxënësve nga dy shkollat mike, Qendra e Kompetencës ‘Kujtim Krasniqi’ në Malishevë dhe Gjimnazi ‘Oso Kuka’ nga Shkodra. Pas prezantimit u zhvillua një diskutim i hapur me nxënësit, ku ata ndanë mendimet e tyre, ngritën pyetje dhe theksuan rëndësinë e respektimit të diversitetit dhe barazisë gjinore në jetën e përditshme dhe në shkollë.

16 Ditë të Aktivizmit Kundër Dhunës në Baza Gjinore



Hapja zyrtare e fushatës 16 Ditë të Aktivizmit është realizuar në ambientet e bibliotekës, jo rastësisht, duke e lidhur atë me bazën e edukimit dhe arsimimit, si faktorë të rëndësishëm në parandalimin e dhunës. Të pranishëm ishin edhe pjesëmarrës të interesuar, të cilët janë lexues të librave që trajtojnë sfidat dhe sukseset e grave që kanë arritur të jenë të njohura në jetën shoqërore dhe politike.



Po ashtu, nxënësit pjesëmarrës lexuan ese të përgatitura prej tyre lidhur me parandalimin e dhunës në familje, të vendosura në këndin e leximit të bibliotekës, duke dhënë një mesazh të fortë ndërgjegjësimi dhe reflektimi.



Gjatë takimit, secili nga pjesëmarrësit, në bazë të fushës së tij të veprimtarisë, dha kontributin e vet në diskutim, i cili u vlerësua si i frytshëm dhe konstruktiv për krijimin e një mjedisi më të sigurt dhe më të barabartë për të gjithë.



Pjesëmarrës - përfaqësues të institucioneve, organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit. Përgjatë takimit u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional, angazhimit të përbashkët dhe rolit të komunitetit në parandalimin dhe adresimin e dhunës në baza gjinore. Ky aktivitet shënoi fillimin e fushatës me synim rritjen e ndërgjegjësisë dhe forcimin e përpjekjeve të përbashkëta kundër dhunës.



Policia e Kosoves-Stacioni Policor-Malishevë dhe Qendra për Punë Sociale u përfshinë në mënyrë aktive në fushatë, duke ofruar informata mbi të drejtat e viktimave, këshillim për parandalimin e dhunës dhe mbështetje për raportimin e rasteteve. Poashtu në këtë takim u përfshinë edhe pjesëmarrës tjerë duke diskutuar secili nga fusha e vet përkatëse.



Dhomë-Mike në stacionin policor, e kompletuar për trajtimin e rasteve me kërkesë nga ZBGJ ku pjesëmarrësit u njohën nga zyrtari policor me mënyrën e funksionimit të dhomës, procedurat për ofrimin e mbështetjes për viktimat e dhunës dhe rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe sigurisë së tyre. Kjo informatë shërbeu si një mjet vetëdijësues për të kuptuar rolin e Policisë në parandalimin dhe trajtimin e dhunës në baza gjinore, si dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional.

Gjatë fushatës 16 Ditë të Aktivizmit Kundër Dhunës në Baza Gjinore u përfshinë të gjitha shkollat dhe u angazhuan aktivisht në një sërë aktiviteteve edukativo-artistike për të promovuar parandalimin e dhunës dhe barazinë gjinore. Nxënësit morën pjesë në ligjërata informative mbi të drejtat dhe barazinë gjinore, pjesë teatrale që pasqyronin situata të ndryshme të dhunës dhe mënyra për t'i parandaluar ato, ese ku shprehën mendimet dhe përvojat e tyre, si dhe aktivitete të artit pamor që transmetonin mesazhe ndërgjegjëse për komunitetin.

Përmes këtyre aktiviteteve nxënësit zhvilluan kreativitetin dhe aftësitë e tyre shprehëse, por edhe u angazhuan në diskutime të hapura dhe reflektime mbi rëndësinë e respektit, barazisë dhe bashkëjetesës pa dhunë. Ky angazhim i plotë i shkollave krijoi një mjedis gjithëpërfshirës dhe sensibilizues duke forcuar ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve në parandalimin e dhunës në baza gjinore.





Konventa e Stambollit - u zhvillua me pjesëmarrjen e të rinjeve, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e parandalimit dhe luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Gjatë aktivitetit, të rinjtë u njohën me përmbajtjen, qëllimet dhe parimet kryesore të Konventës së Stambollit. Nëpërmjet diskutimeve, punës në grupe dhe prezantimeve, pjesëmarrësit analizuan situatën aktuale të dhunës me bazë gjinore në vendin tonë, sfidat në zbatimin e ligjeve, si dhe rolin e të rinjeve në promovimin dhe rolin e barazisë gjinore.



Regjistrimi i bizneseve – përkrahur nga Rrjeti “Qeliza” doli si propozim nga gratë për të diskutuar rreth regjistrimit dhe menyrës së fillimit të bizneseve për të promovuar punën dhe produktet e tyre nga fusha të ndryshme si dhe krijimi i lehtësirave për zhvillimin aktiv të një biznesi, të ftuar zyrtar nga drejtoria për buxhet e financa. Poashtu në vazhdim dëgjuam përvojën dhe suksesin e njëres prej pjesëmarrëseve e cila vazhdon të punojë pa u ndalur në fushën e rrobaqepsisë dhe që është model për gratë e tjera për të vazhduar me punën e tyre.



Takim i përbashkët me pjesëmarrjen e pesë komunave dhe prezantimi i punës dhe aktiviteteve të përbashkëta, të përkrahura nga Rrjeti “Qeliza”



Takimi përmbyllës i fushatës ‘16 Ditë të Aktivizmit kundër Dhunës në Baza Gjinore’ shërbeu si një moment reflektimi dhe vlerësimi i të gjitha aktiviteteve të realizuara gjatë fushatës. Gjatë këtij takimi u përmbledhën aktivitetet e zhvilluara në bashkëpunim me institucionet, Policinë, Qendrën për Punë Sociale, shkollat, grupe të grave dhe komunitetin.

U theksua rëndësia e hapjes zyrtare të fushatës me përfshirjen e institucioneve dhe komunitetit, organizimi i ligjëratave dhe diskutimeve me nxënës për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, si dhe angazhimi i shkollave përmes aktiviteteve edukativo-artistike, përfshirë pjesë teatrale, ese dhe art pamor. Po ashtu, u përmend kontributi i Policisë dhe QPS-së në informimin për raportimin e rasteve, mbrojtjen e viktimave dhe funksionimin e Dhomës Mike në stacionin policor.

Takimi përmbyllës nënvizoi rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional dhe angazhimit të vazhdueshëm të të gjitha palëve për parandalimin e dhunës në baza gjinore, si dhe nevojën për vazhdimësi të aktiviteteve ndërgjegjëse edhe pas përfundimit të fushatës.



Me rastin e 3 Dhjetorit – Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, u organizua një takim me mësueset mbështetëse, gjatë të cilit u diskutuan çështje që lidhen me përfshirjen dhe mbështetjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor.

Takimi u fokusua në rolin e mësueseve mbështetëse në zbatimin e praktikave gjithëpërfshirëse, promovimin e barazisë dhe respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara



Në bazë të kërkesës tonë është realizuar dhe kompletuar me sukses Kabineti i Informatikës në Handikos-Malishevë, dedikuar për fëmijët me nevoja të veçanta, i pajisur me teknologji ndihmëse. Hapësira e re u krijua me përkrahjen e LMT zvicerane dhe CIMIC italian, të cilët kontribuan në kompletimin e këtij kabineti, kjo hapësirë do të ofrojë një ambient gjithëpërfshirës dhe të sigurt, duke u mundësuar fëmijëve zhvillimin e aftësive digjitale, rritjen e pavarësisë dhe qasje të barabartë në edukim.



Vizitë me Grupin e Grave në QKRMT

Gjatë takimit, u njoftuam nga afër me punën shumëvjeçare të QKRMT-së në mbështetje të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Takimi u zhvillua në një frymë të ngrohtë duke na dhënë mundësinë të dëgjojmë dhe të njihemi me pinën e tyre, përkushtimin afatgjatë në ofrimin e shërbimeve psikosociale, shëndetit mendor, përkrahjes ligjore, si dhe fuqizimit social dhe ekonomik për të mbijetuarit.

Të dhënat statistikore në baza gjinore

Komuna e Malishevës ka 43.888 banorë me numër të përgjithshëm.

22.572 femra dhe

21.316 meshkuj

Prej 41 shkollave amë dhe dy paraleleve kemi 5 drejtoresha dhe një drejtoreshë e çerdhes.

Nga dy çerdhe në Malishevë e Kjevë, janë subvencionuar 16 fëmijë

Të regjistruara 193 biznese, 31 femra 162 meshkuj

Institucioni	Nr i përgjithshëm	Gra	Burra	%
Komuna	122	24	98	19 %
Shëndetësi	142	75	67	52%

Asambleja Komitetet	Nr i përgjithshëm	Gra	Burra	Perqindja
A.komunale	31	11	20	35%
KPF	7	3	4	42%
K.Komunitete	5	3	2	60%

Bashkëpunimet e ZBGJ

- Bashkëpunimi me zyrtarin ligjor nga zyra e avokatit të popullit në nivel regjional (çdo muaj me ditën e hapur me qytetarë)
- Janë mbajtur 18 takime në QAK
- Kanë ndjekur kursin e kompjuterit 10 gra (Shoqata Fatjona-Gratë për Gratë)
- Kanë pëfituar 22 gra – 3 gra sera dhe 19 gra kanë përfituar mjete pune (Shoqata Fatjona-Gratë për Gratë)
- Bashkëpunimi me ABGJ
- Bashkëpunimi me zyrtarin për ndihmë juridike falas
- Bashkëpunimi me shkollat
- Bashkëpunimi me Rrjetin “Qeliza”

Zyrtarja për Barazi Gjinore

Vera Bytyçi
